



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 206

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 10 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 399, datë 5.12.2024	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin..... 22199
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 4.12.2024	Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 22199
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 740, datë 4.12.2024	Për lirimin dhe emërimin e një anëtarit të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës..... 22199
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 741, datë 4.12.2024	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si dhe për shfuqizimin e së drejtës së përdorimit Bashkisë Korçë, Njësia Administrative Drenovë, për pasuritë me nr. 86, nr. 87 dhe nr. 91, zona kadastrale 1538, si dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të pasurive me nr. 362 e nr. 364, zona kadastrale 1538, me vendndodhje në Drenovë, Korçë, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 742, datë 8.9.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 22200
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 4.12.2024	Për përcaktimin e procedurave të trajtimit financiar për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë në rastet e fatkeqësive në familje, shpërblimin për rezultatet e arritura dhe dëmtimin e rëndë të pronës private për shkak të detyrës 22203
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 743, datë 4.12.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 391, datë 3.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar..... 22204
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 744, datë 4.12.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, të ndryshuar..... 22205

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 4.12.2024	Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me licencë të sipërmarrësve, që operojnë në treg me gazet serrë të fluoruar dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze.....	22206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 4.12.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.....	22207
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 27.11.2024	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 1.12.2023, “Për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe detyrave të tij në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”	22208
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 650, datë 4.12.2024	Për delegim kompetencash.....	22209
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Petraq Pali....	22210

**DEKRET****Nr. 399, datë 5.12.2024****PËR CAKTIMIN E DATËS SË
ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN**

Në mbështetje të nenit 65, pikat 1 dhe 2, nenit 92, shkronja “gj”, dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8 dhe nenit 9, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zgjedhjet për Kuvendin të zhvillohen ditën e diel, në datën 11 maj 2025.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 739, datë 4.12.2024****PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË
EKIPIT PËRZGJEDHËS PËR
ZGJEDHJEN E KANDIDATËVE,
ANËTARË TË KOMISIONIT
KOMBËTAR RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Hermon Bonati caktohet anëtar i ekipit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

2. Vendimi nr. 619, datë 1.11.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 740, datë 4.12.2024****PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E NJË
ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES
TË AGJENCISË SHETETËRORE
TË KADASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ismail Shehu, anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Eduard Ahmeti emërohet anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIM

Nr. 741, datë 4.12.2024

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, SI DHE PËR SHFUQIZIMIN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT BASHKISË KORÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË, PËR PASURITË ME NR. 86, NR. 87 DHE NR. 91, ZONA KADASTRALE 1538, SI DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT TË PASURIVE ME NR. 362 E NR. 364, ZONA KADASTRALE 1538, ME VENDNDODHJE NË DRENOVË, KORÇË, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 742, DATË 8.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 820, DATË 13.10.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të nenit 14, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për pasuritë me nr. 86, nr. 87, nr. 91, zona kadastrale 1538, me vendndodhje në Drenovë, Korçë.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të pasurive me nr. 362 e nr. 364, zona kadastrale 1538, me vendndodhje në Drenovë, Korçë.

3. Pronat e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, janë sipas formularit dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’u përdorur për ngritjen e projektit “Ferma e dijes dhe agroturizmit të mollëve”.

4. Për pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet e drejta e përdorimit për Bashkinë Korçë, Njësia Administrative Drenovë, inventarizuar me numër rendor 14, 15 dhe 19, sipas listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore dhe lidhjes 1, bashkëlidhur vendimit nr. 742, datë 8.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Drenovë të qarkut të Korçës”, të ndryshuar, si dhe hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, të ndryshuar.

5. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, si dhe tjetërsimi i tyre.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Korçë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 742, datë 4.12.2024****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË TRAJTIMIT FINANCIAR PËR
PUNONJËSIT E GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
RASTET E FATKEQËSIVE NË FAMILJE,
SHPËRBLIMIN PËR REZULTATET E
ARRITURA DHE DËMTIMIN E RËNDË
TË PRONËS PRIVATE PËR SHKAK
TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë procedurat e trajtimit financiar për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë në rastet e fatkeqësive në familje, shpërblimin për rezultatet e arritura dhe dëmtimin e rëndë të pronës private për shkak të detyrës, në zbatim të shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. NDIHMA FINANCIARE NË RASTIN E FATKEQËSIVE NË FAMILJE

1. Për efekt të këtij vendimi, fatkeqësi në familje konsiderohet vdekja e prindit në ngarkim, e bashkëshortit/bashkëshortes apo e fëmijës.

2. Ndihma financiare për fatkeqësitë në familje jepet në masën e 2 (dy) pagave mujore neto të muajit të fundit.

3. Për t’u trajtuar me ndihmë financiare sipas pikës 2, të këtij kreu, punonjësi dorëzon në Gardën e Republikës:

- a) kërkesën me shkrim;
- b) certifikatën e vdekjes së prindit në ngarkim, të bashkëshortit/bashkëshortes apo të fëmijës;
- c) certifikatën familjare.

4. Pagesa për ndihmë të menjëhershme financiare për fatkeqësi në familje bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm.

III. SHPËRBLIMI I PUNONJËSIT TË GARDËS SË REPUBLIKËS

1. Punonjësi i Gardës së Republikës përfiton në vit një shpërblim deri në masën e 3 (tri) pagave mujore neto për rezultate të larta të arritura gjatë kryerjes së detyrës. Shpërblimi jepet në bazë të këtyre kriterëve:

a) punonjësi pëson dëmtime shëndetësore gjatë shërbimit për sigurimin e personaliteteve apo të objekteve në ruajtje, duke përfshirë raste, si: sulme të dhunshme, aksidente gjatë detyrës ose situata emergjente, që shkaktojnë paafësi të përkohshme në punë për më shumë se 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike;

b) parandalohet një incident i rëndë apo përpjekje për dëmtim fizik të personaliteteve me masa konkrete dhe ndërhyrje të menjëhershme të punonjësit të Gardës;

c) kryhen shërbime për sigurinë e personaliteteve dhe të objekteve në kushte të rrezikshme, si: gjatë protestave masive, kërcënimeve terroriste të konfirmuara, situatave të tensionuara me rrezik ose detyra të përshkallëzuara papritur, që kërkojnë vigjilencë të lartë dhe aftësi të shpejta reagimi;

ç) punonjësi kryen detyra sigurie në aktivitete madhore, ku marrin pjesë më shumë se 10 (dhjetë) personalitete të rëndësishme vendase dhe ndërkombëtare, si: samite të nivelit të lartë, takime ndërkombëtare ose ceremoni shtetërore me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare.

2. Masa e shpërblimit jepet e përshkallëzuar sipas klasifikimit:

a) 3 (tri) paga mujore neto, për plotësimin e kriterit të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu;

b) 2 (dy) paga mujore neto, për plotësimin e kriterit të shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij kreu;

c) 1 (një) pagë mujore neto, për plotësimin e kriterit të shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij kreu.

IV. NDIHMA E MENJËHERSHME FINANCIARE NË RAST TË DËMTIMIT TË RËNDË TË PRONËS PËR SHKAK TË DETYRËS

1. Punonjësi i Gardës së Republikës, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private për shkak të detyrës, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare, sipas akteve të vlerësimit të dëmit, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Punonjësi e përfiton ndihmën e menjëhershme financiare kur:



a) prona i është dëmtuar si pasojë e veprës penale, e kryer në dëm të punonjësit për shkak të detyrës, si dhe rasti është paraqitur pranë organeve ligjzbatuese;

b) disponon dokument, që vërteton pronësinë e pronës së dëmtuar;

c) nuk ka përfituar dëmshpërblim nga një shoqëri sigurimi për dëmtimin e pronës.

V. PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR SHPËRBLIM DHE NDIHMË TË MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Drejtori i përgjithshëm i Gardës urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm, sipas rasteve të parashikuara në krerët III dhe IV, të këtij vendimi.

2. Komisioni i posaçëm ka në përbërjen e tij 5 (pesë) anëtarë:

a) zëvendës drejtorin e përgjithshëm i Gardës;

b) drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse;

c) shefin e sektorit të buxhet-financës;

ç) shefin e sektorit të burimeve njerëzore;

d) një punonjës me profil jurist.

3. Eprori i drejtpërdrejtë dhe në hierarki më i larti paraqet pranë komisionit të posaçëm propozimin për shpërblim, të shoqëruar me relacion shpjegues të rezultateve konkrete të arritura nga punonjësi, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të kreut III, të këtij vendimi.

4. Pagesa për shpërblimin e punonjësit bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, sipas vendimit të komisionit të posaçëm.

5. Në rastet e dëmtimit të rëndë të pronës, të parashikuar në pikat 1 e 2, të kreut IV, të këtij vendimi, komisioni mblidhet dhe kryen verifikimet e vlerësimet përkatëse, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e paraqitjes së kërkesës së punonjësit.

6. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, punonjësi dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim për përfitimin e dëmshpërblimit, duke parashtruar faktin e dëmtimit;

b) kopjen e shkresës për referimin e veprës penale në organet ligjzbatuese;

c) kopjen e noterizuar të dokumentit, që vërteton pronësinë për pronën e dëmtuar;

ç) aktin e vlerësimit të dëmit nga një ekspert i licencuar.

7. Pagesa për ndihmë të menjëhershme financiare për dëmin e shkaktuar bëhet me urdhër të

drejtorit të përgjithshëm, sipas vendimit të komisionit të posaçëm.

8. Kur nga hetimi apo gjykimi i çështjes provohet se dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur për shkak të detyrës, punonjësi, që ka përfituar ndihmë të menjëhershme financiare, është i detyruar të kthejë në masën 100 (njëqind) % shumën e përfituar.

9. Në rast mosdakordësie mbi propozimin për shpërblim të punonjësit apo të dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare, punonjësi ankimon vendimin e komisionit të posaçëm te drejtori i përgjithshëm i Gardës.

10. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës vendos për pranimin ose refuzimin e ankimit të punonjësit. Në rast të pranimit të ankimit, propozimi për shpërblim të punonjësit apo dhënie ndihme të menjëhershme financiare rikthehet për rishqyrtim në komisionin e posaçëm.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme në programin buxhetor “Garda e Republikës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2025.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 743, datë 4.12.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 391, DATË 3.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT DHE TË PUBLIKIMIT NË QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 391, datë 3.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

I. Në kreun I, “Organizimi i sporteve”, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i kreut “Organizimi i sporteve” zëvendësohet me “Portali “e-Albania””.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Aplikimi për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) bëhet pranë portalit “e-Albania”.

3. Pika 3 shfuqizohet.

II. Në kreun II, “Kërkesa të përgjithshme të aplikimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5, fjalët “... pranë QKB-së ...” hiqen.

2. Në pikën 6, fjala “... paraqesin ...” zëvendësohet me fjalët “... ngarkojnë elektronikisht ...”.

III. Kreu III, “Procedurat e aplikimit pranë sportelit qendror dhe sporteve të shërbimit në territor”, që përbëhet nga pikat 10 deri në 23, shfuqizohet.

IV. Në kreun V, “Procedurat e vlerësimit të aplikimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 33, fjalët “... pikës 23 apo ...” hiqen.

2. Pika 34 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“34. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së verifikon me hollësi nëse aplikimi dhe dokumentet shoqëruese janë në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 54, të ligjit, të regjistrimit të biznesit, si dhe verifikon veprimet e kryera nga personi i autentifikuar elektronikisht.”.

3. Në pikën 41, fjalët “... III ose ...” hiqen.

4. Në shkronjën “b”, të pikës 44, fjalët “... III ose ...” hiqen.

V. Në kreun VI, “Dispozita për njoftimin e vendimeve”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 46 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“46. Çdo vendim i QKB-së në lidhje me miratimin, pezullimin apo refuzimin e aplikimit i njoftohet në mënyrë elektronike aplikantit në portalin “e-Albania”, si dhe në faqen zyrtare të QKB-së, jo më vonë se 1 (një) ditë nga data e paraqitjes së aplikimit.”.

2. Pikat 47 dhe 48 shfuqizohen.

3. Në pikat 50 dhe 51, fjala “... të paraqesë ...” zëvendësohet me fjalët “... të ngarkojë elektronikisht në portalin “e-Albania” ...”.

VI. Në kreun VII, “Dispozita për publikimin elektronik dhe marrjen e informacionit”, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 54, pas fjalëve “... në faqen zyrtare të internetit të QKB-së ...” shtohen fjalët “... si dhe në portalin “e-Albania” ...”.

2. Pikat 55 dhe 56 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“55. Çdo person i interesuar, pa qenë i detyruar të identifikohet, mund të kryejë kërkime në të dhënat e publikuara nga QKB-ja në faqen zyrtare për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve. Këto kërkime mund të kryhen elektronikisht në faqen zyrtare të QKB-së.

56. Çdo person ka të drejtë të marrë, në format elektronik, ekstrakte për të dhënat e regjistruara të çdo subjekti. Gjithashtu, çdo person mund të marrë, në format shkresor, kopje të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistrë, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.”.

3. Pikat 57, 58, 59 dhe 60 shfuqizohen.

VII. Në kreun X, “Procedurat e korrigjimit të gabimeve”, pika 70 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“70. Aplikimi për korrigjimin e gabimit mund të bëhet *on-line* nga subjekti, të cilit i përkasin të dhënat, nëpërmjet portalit “e-Albania”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 744, datë 4.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 78, DATË 7.2.2007,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MASËN, KRITERET DHE
PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË
PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-
SANITARE PËR INVALIDËT
PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për



statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “...16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj...” zëvendësohet me “...20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj...”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Shërbimi Social Shtetëror i përcjell çdo vit Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përlllogaritjen e indeksimit të pagesës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i propozon për miratim Këshillit të Ministrave pagesën e indeksuar për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.”.

3. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimet “ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohen me fjalët “...ministri përgjegjës për çështjet sociale...” dhe “...ministra përgjegjëse për çështjet sociale...”.

II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 745, datë 4.12.2024

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR PAJISJEN ME LICENCË TË SIPËRMARRËSVE, QË OPEROJNË NË TREG ME GAZET SERRË TË FLUORUARA DHE PAJISJET QË PËRMBAJNË KËTO GAZE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen e sipërmarrësit me licencën, që përfshihet në kategorinë III.3.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, ngarkohet gjatë aplikimit në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe është, si më poshtë vijon:

a) Për licencën me kodin III.3.B.1:

i. autorizimi, që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar licencën dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit;

ii. kontrata e lidhur ndërmjet sipërmarrësit dhe drejtuesit teknik në fushën e veprimtarive me gazet serrë të fluoruara dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze;

iii. diploma për arsimin e mesëm ose të lartë të drejtuesit teknik;

iv. dokumenti i pronësisë ose kontrata e përdorimit të mjediseve, ku sipërmarrësi do të operojë me gaze serrë të fluoruara ose pajisje që përmbajnë këto gaze;

v. vetëdeklarimi mbi përshtatshmërinë e mjediseve për importin, eksportin, magazinimin e gazeve serrë dhe të pajisjeve që përmbajnë këto gaze, që lidhet me sigurimin e sistemeve të përshtatshme të ventilimit, të sigurisë nga zjarri dhe të kushteve të magazinimit të përshtatshme për të trajtuar gazet nën presion.



b) Për licencën me kodin III.3.B.2:

i. Autorizimi, që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar licencën dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit;

ii. diploma për arsimin e mesëm ose të lartë të drejtuesit teknik;

iii. vetëdeklarimi në rastin kur sipërmarrësi kryen vetë funksionet e operatorit dhe është person i certifikuar, shoqëruar me certifikatën përkatëse;

iv. vetëdeklarimi në rastin kur sipërmarrësi kryen vetë funksionet e operatorit, por nuk është person i certifikuar; në këtë rast, vetëdeklarimi shoqërohet edhe me kontratën e punës dhe certifikatën e personit të kontraktuar;

v. kontrata me operatorin, në rastin kur sipërmarrësi nuk është operator, si dhe kontrata me personin e certifikuar, të shoqëruar me certifikatën përkatëse;

vi. dokumenti i pronësisë ose kontrata e përdorimit të mjediseve, ku sipërmarrësi do të operojë me gaze serrë të fluoruara ose pajisje që përmbajnë këto gaze;

vii. vetëdeklarimi mbi përshtatshmërinë e mjediseve për vendosjen në treg të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara dhe/ose gazeve serrë të fluoruara, në funksion të instalimit, të shërbimeve, të mirëmbajtjes ose të riparimit të pajisjeve të gazeve serrë dhe të pajisjeve, që përmbajnë këto gaze, që lidhet me sigurimin e sistemeve të përshtatshme të ventilimit, të sigurisë nga zjarri dhe të kushteve të magazinimit të përshtatshme për të trajtuar gazet nën presion.

2. Sipërmarrësi, që kërkon të pajiset me licencën me kodin III.3.B.2, aplikon kur veprimtaria kryhet në funksion:

a) të kryerjes së instalimit, të shërbimeve, të mirëmbajtjes ose të riparimit të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet mbi ato gaze;

b) të vendosjes në treg të pajisjeve të mbyllura johermetikisht, të mbushura me gaz serrë të fluoruar.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 746, datë 4.12.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 568, DATË 6.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT, ORËT SHITESË DHE KOMPENSIMIN E TYRE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, INSTITUCIONET E PAVARURA DHE NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 40, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të neneve 76, 78, 79, 83, 85, 86, 87 e 94, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun III, të vendimit nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shitesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “... 4 (katër) javë kalendarike ...” zëvendësohet me “... 22 (njëzet e dy) ditë pune ...”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. I punësuari ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor të paguar edhe në periudha të ndryshme e të ndara.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**UDHËZIM****Nr. 22, datë 27.11.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 25, DATË 1.12.2023,
“PËR PILOTIMIN E SKEMËS SË
MËSUESIT NË DISPOZICION DHE
DETYRAVE TË TIJ NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 57, të neneve 26 dhe 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 25, datë 1.12.2023, “Për pilotimin e skemës së mësuesit në dispozicion dhe detyrave të tij në institucionet arsimore publike të

arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Kudo në përmbajtje togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar” zëvendësohet me togfjalëshin “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar”.

b) në pikën 1, të kreut I, togfjalëshi “...për vitin shkollor 2023–2024.” bëhet “...për vitin shkollor 2024–2025.”;

c) aneksi 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e udhëzimit, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nina Guga**

ANEKSI 2**a) Numri i mësuesve në dispozicion sipas ZVAP-së ku do të emërohen**

Nr.	DRAP	ZVAP	Numri i mësuesve në dispozicion
1	Durrës	Dibër	2
2	Durrës	Durrës	6
3	Durrës	Krujë	2
4	Tiranë	Kamzë	6
5	Tiranë	Tiranë	20
6	Tiranë	Vorë	2
7	Fier	Fier	6
8	Fier	Gjirokastrë–Libohovë	2
9	Fier	Lushnjë	2
10	Fier	Sarandë–Delvinë–Konispol	2
11	Fier	Vlorë–Himarë	6
12	Korçë	Berat	2
13	Korçë	Elbasan	6
14	Korçë	Korçë–Pustec	2
15	Korçë	Librazhd	2
16	Korçë	Përrenjas	2
17	Lezhë	Has	2
18	Lezhë	Kukës	2
19	Lezhë	Lezhë	2
20	Lezhë	Shkodër	6
		Gjithsej mësues	82



b) Institucionet arsimore ku do të pilotohet përforcimi

Nr.	DRAP	ZVAP	Institucioni arsimor	Lloji i IA-së	Numri i nxënësve
1	Tiranë	Tiranë	“Kongresi i Manastirit”	Arsim bazë	1462
2	Tiranë	Tiranë	“Edith Durham”	Arsim bazë	819
3	Tiranë	Tiranë	“Vasil Shanto”	Arsim bazë	1207
4	Tiranë	Tiranë	“Fan S. Noli”	Arsim bazë	1070
5	Tiranë	Tiranë	“Emin Duraku”	Arsim bazë	1286
6	Tiranë	Kamzë	“100 Vjetori”	Arsim bazë	1330
7	Tiranë	Kamzë	“Azem Hajdari”	Arsim bazë	1242
8	Tiranë	Vorë	“Vajdin Lamaj”	Arsim bazë	728
9	Durrës	Krujë	“Adem Gjeli”	Arsim bazë	1597
10	Fier	Sarandë–Konispol–Delvinë	“Adem Sheme”	Arsim bazë	945
11	Fier	Fier	“Andon Xoxa”	Arsim bazë	895
12	Durrës	Durrës	“Qemal Mici”	Arsim bazë	985
13	Korçë	Elbasan	“Luigj Gurakuqi”	Arsim bazë	627
14	Lezhë	Shkodër	“Ismail Qemali”	Arsim bazë	844
15	Durrës	Durrës	“Marie Kaçulini”	Arsim bazë	889
16	Durrës	Dibër	“Selim Alliu”	Arsim bazë	797
17	Fier	Gjirokastër–Libohovë	“Koto Hoxhi”	Arsim bazë	815
18	Fier	Fier	“Naim Frashëri”	Arsim bazë	860
19	Lezhë	Kukës	“Avni Rustemi”	Arsim bazë	808
20	Fier	Vlorë–Himarë	“Ismail Qemali”	Arsim bazë	808
21	Lezhë	Has	“Sejdi Dida”	Arsim bazë	774
22	Lezhë	Shkodër	“Ndre Mjeda”	Arsim bazë	702
23	Fier	Vlorë–Himarë	“Jani Minga”	Arsim bazë	963
24	Fier	Lushnjë	“Skënder Libohova”	Arsim bazë	674
25	Korçë	Korçë–Pustec	“Sevasti Qirjazi”	Arsim bazë	675
26	Korçë	Elbasan	“Jorgji Dilo”	Arsim bazë	702
27	Lezhë	Lezhë	“Besëlidhja”	Arsim bazë	720
28	Korçë	Përrenjas	“Qybra Sokoli”	Arsim bazë	604
29	Korçë	Librazhd	“Genc Leka”	Arsim bazë	590
30	Korçë	Berat	“22 Tetori”	Arsim bazë	500

URDHËR

Nr. 650, datë 4.12.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtorit të Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 5.12.2024 deri në datën 6.12.2024.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padele-gueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido



KËRKESË

Shtetasi Benard Pali kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Petraq Pali, i lindur në Vlorë, më 10.9.1970, me atësi Todi dhe amësi Androniqi.

KËRKUES
Benard Pali

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë

